

Data 10.02.2023
Ora 14:11

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 31.10.2020 të Komisionit Rregullator, “Për llojin dhe karakteristikat teknike, që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë””.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y. Merkaj, M. Koja |
| Parti | Politike: | S’ka prezent |
| Të | tjerë: | KRIIK |

Znj. I. Nano: Mirdita! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, të njoftuar për ditën e sotme. Jemi pak me vonesë, ndaj kërkojmë ndjesë! Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator: sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës. Në mbledhjen e sotme, siç është njoftuar, kemi dy pika në rendin e ditës: shqyrtimin e projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator “Për llojin dhe karakteristikat teknike, që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, që

Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, dhe projektvendimin e dytë: “Për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për llojin dhe karakteristikat teknike, që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë””.

Projektvendimi i parë ka ardhur si iniciativë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe nënkomisioneres Shtetërore të Zgjedhjeve, ndërsa projektvendimi i dytë ka ardhur si iniciativë e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Kolegë, përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimeve, kemi ndonjë propozim për ndryshime në rendin e ditës? Po, zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Faleminderit, kryetare! Atëherë, nisur nga fakti që, në gjykimin tim, pika e dytë e parashikuar në rendin e ditës, projektvendimi “Për disa ndryshime në vendimin nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për llojin dhe karakteristikat teknike, që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë””, siç e theksova, për arsye se ka nevojë për disa shtesa, apo për t’u riparë nga ana jonë, unë propozoj që të hiqet nga rendi i ditës dhe të vijojë shqyrtimi i rendit të ditës me pikën 1 të parashikuar.

Znj. I. Nano: Dakord. Faleminderit! Kolegët kanë ndonjë propozim tjetër për ndryshime në rendin e ditës? Nëse jo, votojmë propozimin e zotit Çakaj për të hequr nga rendi i ditës pikën 2, për të mos shqyrtuar sot projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për llojin dhe karakteristikat teknike, që duhen të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

Pro: 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Dakord, të gjithë.

Atëherë mbetet për t'u shqyrtuar vetëm projektvendimi i parë që, sikundër ju thashë, është propozim i Komisionerit dhe i nënkomisioneres. Zoti sekretar i Përgjithshëm, do t'ju lutesha të bënit prezantimin e projektaktit dhe një shpjegim lidhur me nevojën për ndryshime!

Z. Y. Merkaç: Atëherë referuar nenit 20 të Kodit Zgjedhor, "Komisioni Rregullator" ku parashikohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga 2 stafet e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, kemi paraqitur edhe projektvendimin e mësipërm "Për një shtesë në vendimin nr. 2, datë 31.10.2020, të Komisionit Rregullator "Për llojin dhe karakteristikat teknike, që duhen të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e identifikimit elektronik të zgjedhësve, që prokurohen dhe përdoren për zgjedhje në Republikën e Shqipërisë"". Qëllimi i projektvendimit të mësipërm është të përcaktojmë llojin dhe karakteristikat teknike, që duhen të plotësojnë sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit, që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje; specifikisht, sistemi elektronik i identifikimit të votuesve dhe pajisjet elektronike të identifikimit *PEI*, të vendosura në çdo qendër votimi, të cilat sigurojnë identifikimin e saktë të zgjedhësve, bazuar në regjistrin elektronik të mbajtur në këtë pajisje. Projektvendimi i propozuar për miratim përmban një shtesë në tekstin e njëres prej pikave, konkretisht të shkronjës "c", të pikës 5, të vendimit nr. 2, datë 31.10.2020, me këtë përmbajtje: "Përjashtimisht, me qëllimin e pasqyrimit të pjesëmarrjes në zgjedhje, çdo pajisje elektronike e identifikimit duhet të transmetojë periodikisht të dhënat statistikore mbi pjesëmarrjen gjatë ditës së zgjedhjeve dhe të serverit qendror të KQZ-së dhe jo anasjelltas, si dhe statusin e qendrës së votimit në mënyrë të sigurt dhe pa

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

cenuar integritetin e informacionit.” Elemente kryesore të procesit të identifikimit janë sistemi elektronik i identifikimit të votuesve *SAVE* dhe pajisja elektronike e identifikimit *PEI*. *SAVE* bën të mundur konfigurimin e pajisjes së plotë të pajisjeve *PEI* dhe qendëzimin e të dhënave, në mënyrë të sigurt në të gjitha pajisjet *PEI*. Gjithashtu, mundëson konsolidimin dhe nxjerrjen e statistikave pas mbylljes së procesit të votimit nga çdo pajisje *PEI*. Pajisjet *PEI* janë pajisje të sigurta, që mundësojnë identifikimin elektronik, duke u ruajtur informacioni në memorie fizike të veçantë, të cilat në përfundim të procesit qendëzohen nga sistemi elektronik i identifikimit të votuesve, nga ku nxirret informacioni i saktë në lidhje me pjesëmarrjen. Mundësimi i këtyre të dhënave do të bëhet nëpërmjet një modemi *USB*, me kartë *SIM*, i cili do të vendoset në një nga portat *USB* të pajisjes elektronike *PEI*, që do të mundësojë transferimin e të dhënave statistikore të gjeneruara nga pajisjet si rrjedhojë e identifikimit të zgjedhësve. Garancitë e lidhura me sigurinë e informacionit: është një transmetim vetëm në njërin kah, pra kemi vetëm dalje të informacionit dhe jo hyrje. Për më tepër, metoda e menaxhimit të informacionit pajisje është *really only*, pra, është e pamundur të identifikohet informacioni në pajisje. Një ndër garancitë e lidhura me sigurinë e informacionit është një transmetim vetëm në njërin kah, pra kemi vetëm dalje të informacionit dhe jo hyrje. Për më tepër metoda e menaxhimit të informacionit të pajisjes është *really only*, pra është e pamundur të modifikohet informacioni në pajisje. Një ndër avantazhet e këtij informacioni është disponimi i informacionit me frekuencë çdo një orë për pjesëmarrjen e zgjedhësve në qendrat e votimit. Rregullat e hollësishme për vënien e të dhënave, që transmetohen nga pajisja *PEI* dhe mënyra e transmetimit do të miratohen me akt të posaçëm të Komisionit Rregullator. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin e miratimit. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj!

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

Atëherë, kolegë, çelim diskutimin në parim të projektvendimit, ndërkohë kemi edhe zyrtarët e administratës që mbulojnë pikërisht çështjet e teknologjisë së Informacionit dhe posaçërisht dhe përdorimin e PEI-t. A keni diçka në parim për projektvendimin? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Fillojmë trajtimin për çdo pikë të tij. Projektvendimi ka 4 pika.

“Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

Pika 1, “Në shkronjën “c”, të pikës 5, të vendimit nr. 2, datë 31.10.2020 të Komisionit Rregullator shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Përrjashtimisht për qëllim të pasqyrimit të pjesëmarrjes në zgjedhje çdo pajisje elektronike identifikimi të mundësojë transmetimin periodik të të dhënave statistikore mbi pjesëmarrjen gjatë ditës së zgjedhjeve dhe statusin e qendrës së votimit drejt serverit në *cloud* të KQZ –së dhe jo anasjelltas, në mënyrë të sigurtë dhe pa cenuar integritetin e informacionit. Rregullat e hollësishme për llojin e të dhënave, që transmetohen nga pajisja PEI dhe mënyrën e transmetimit miratohen me akt të posaçëm të Komisionit Rregullator””. A keni ndonjë pyetje për pikën 1? Unë personalisht, duke e studiuar aktin, kam një propozim, por para se ta bëj propozimin, nëse keni ndonjë pyetje mund ta bëni. Personalisht në propozimin tim kam menduar që të integrohen në një pikë, pra shkronja “c” e pikës 5, që përmban dhe një fjali plus propozimit që është bërë nga Komisioneri dhe Nënkomisioneri të integrohen në një të vetme. Më lejoni të lexoj propozimin dhe propozimi im është ky: “Shkronja “c” e pikës 5, të vendimit nr. 2 datë 31.10.2020 të Komisionit Rregullator ndryshohet si më poshtë vijon: PEI vepron në mënyrë autonome dhe pa u lidhur në komunikimet e rrjeteve elektronike.

Zbardhi materialin audio

Mirgjina LEKAJ



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

Përrjashtimisht për qëllim të pasqyrimin të pjesëmarrjes në zgjedhje pajisja të mundësojë transmetimin periodik të të dhënave statistikore gjatë ditës së zgjedhjeve drejt infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit TIK, të KQZ-së dhe jo anasjelltas, me siguri maksimale dhe pa cenuar integritetin e informacionit. Lloji i të dhënave që transportohen nga PEI dhe rregullat për mënyrën e transmetimit miratohen me akt të Komisionit Rregullator.” Lidhur me propozimin kolegë, a keni diskutime, nëse jo kalojmë në votimin e këtij propozimi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. “Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.”

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 3. “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.”

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 4. “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.”

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Sipas procedurës, kalojmë në votimin në tërësi të projektaktit pasi e kemi votuar atë në parim dhe për çdo pikë me gjithë ndryshimet tashmë të votuara.

Kush është dakord me projektaktin në tërësi?

Pro: 5 (zgj.Nano, z. Çela, z. Çaka, zgj.Vukaj, z. Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Sikundër u vlerësua dhe u votua nga Komisioni Rregullator në fillim të kësaj mbledhjeje, pika 2 e rendit të ditës do të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të Komisionit Rregullator.

Vendimi nr. 5

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



**Data 10.02.2023
Ora 14:22**

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

KQZ:


- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y. Merkaç, M. Koja**
- **Parti Politike: S'ka prezent**
- **Të tjerë: KRIIK**

Znj. I. Nano: Po, zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Meqenëse nuk u shtrua dhe mori vëmendje spostimi i kësaj pike kam diçka përtej. Të nderuar kolegë, në kuadër të ruajtjes së integritetit të këtij procesi zgjedhor dhe asaj që kemi detyrë të ruajmë ne si risk fillimisht dhe më pas si një nga organet kryesore të drejtimit të KQZ-së, e shqetësuar nga fenomeni, gangrenizimi i dytë do ta konsideroja, fenomen, i cili po bën një bujë të madhe mediatike, aktivisti e ka emrin këtë herë, ngre me shqetësim të madh, jo vetëm administrativ, por edhe për t'ua përcjellë të gjitha institucioneve, të cilat monitorojnë këtë proces dhe kanë për qëllim të vëzhgojnë dhe të ruajnë integritetin dhe garancinë maksimale të votës si e drejtë, por lirisë së votës, ku përfshihet edhe fshehtësia e saj, në të njëjtën kohë edhe integriteti i saj. Analistë

Zbardhi materialin audio

Alma KOLA

P.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

të ndryshëm, falë një denoncimi të një personi të përgjegjshëm, i cili duhet përshëndetur në këtë rast, po e trajtojnë rastin deri në kufijtë e krimit zgjedhor. Do të doja të dija, në kuadër të raporteve të OSBE-ODIHR-it, ku një nga rekomandimet me nr. 2 të tij është siguria për fshehtësinë e votës dhe liria e saj, çfarë kemi bërë ne si administratë dhe sa të investuar apo të shqetësuar kemi qenë për këtë çështje, pasi e dimë shumë mirë ndikimin e një fenomeni paralel siç ishte patronazhimi, i cili na cenoi në detaje çdo të dhënë tonën personale dhe po qasemi drejt një procesi, të cilin, në qoftë se nuk do të parandalojë këtë fenomen të dytë gangrenizues, e shoh me skepticizëm që mund të jetë i garantuar apo mund t'u ofrojë palëve të kenë "armë të barabarta" në këtë "fushë betejë" për të marrë të drejtën e votës nga simpatizantët e tyre. Pra, drejtuar juve, Sekretari i Përgjithshëm, çfarë është bërë deri tani nga administrata? Nëse është bërë, me çfarë aktesh jeni investuar? Nëse nuk është bërë, duhet të dimë se në ç'raport jemi ne si institucion dhe sa vlerë po marrin aktet tona në lidhje me parandalimin apo garantimin e proceseve zgjedhore. Sepse të përpiqesh kaq shumë për të qenë skrupuloz në çdo pikë dhe në respektim të çdo detaji e çdo dispozite të Kodit Zgjedhor, duke garantuar Kushtetutën së pari dhe duke transmetuar besim për të gjithë ata që na ndjekin dhe janë të interesuar për këtë proces, që ju e dini shumë mirë se sa shkon numri i votuesve, pra është një grup interesi jashtëzakonisht i madh, atëherë në këtë kuadër më lind e gjithë e drejta dhe detyrimi të di se ku jemi ne si institucion dhe sa po konsiderohemi ne për të tretët apo të tjerë të investuar për ta zhbërë këtë lloj garancie kushtetuese. Faleminderit! Do të vijojë më pas me dy çështjet e tjera.

Z. Y. Merkaç: Me sa di unë, nuk jam shumë i informuar për këtë aktivistin, është hera e parë që e dëgjoj, nuk kemi pasur në faqen e KQZ-së, ku bëhen raportimet, denoncimet, raste të tilla. KQZ-ja investohet vetëm kur ka një denoncim apo një raportim që të hetojë ndaj një institucioni apo subjekti të ngarkuar, të identifikuar.

Zbardhi materialin audio

Alma KOLA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.10.02.2023*

Znj. H. Vukaj: Unë e mora përgjigjen, por KQZ-ja nuk e ka vetëm në atë rast incentivimin e saj, sepse e detyron neni 12, pika 1, dhe rregullorja, që mund ta nisë hetimin kryesisht. Këto janë veprimtari të ndaluara dhe shumëkush që merret me fushën zgjedhore po i etiketon në kufijtë e krimit zgjedhor, sepse janë të shumta rastet që po denoncohen, që po i bëhet presion administratës për të investuar dhe për t'ia ndikuar votën. Kështu që, pikë së pari, unë do të kërkoja investimin tuaj për të kërkuar te Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave të investohet në këtë çështje dhe te çdo institucion tjetër ligjzbatues, madje edhe te ndërkombëtarët nëse e shohim të nevojshme meqenëse reputacioni ynë ndoshta në këto profile kemi shkuar, që aktet tona si ai i veprimtarive të ndaluara thjesht janë një gjë në letër dhe nuk po shohim ndonjë efekt të madh, sepse përditë kemi veprimtari të ndaluara që shfaqen si për karshillik në medie apo kemi Bashkinë Durrës, është rasti më i freskët, që po shpërndan kompensimet e të ashtuquajturit tërmet në vitin 2023, apo struktura të tjera institucionale, të cilat po rrisin në mënyrë galopante organigramat e tyre. Minimalisht për këtë i shkruhet ose i adresohet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, ku i kërkohet informacion i përditësuar për çdo muaj se çfarë është bërë, çfarë risish ka apo çfarë informacioni mund të marrim nga kjo drejtori dhe kuptohet qartë, ose OSBE-ODIHR-it. Unë personalisht i bëj thirrje OSBE-ODIHR-it që të jenë të investuar që në këtë moment, apo partnerëve tanë, të cilët pikërisht për patronazhimin, drejtues apo shtetarët më të lartë të vendeve të rajonit i kanë “penalizuar” me shpalljen non grata, rasti i Bosnjës. Kështu që kërkoj vëmendjen tuaj maksimale dhe angazhimin tuaj si administratë, e cila e ka për detyrë këtë. Do t’ju lutesha që në mbledhjet e ardhshme të kishim një informacion më të detajuar dhe më konkretë se çfarë është bërë në këtë drejtim. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zonja Vukaj! Çështje tjetër jashtë rendit të ditës kemi për të diskutuar? Nëse jo, e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Zbardhi materialin audio

Alma KOLA

